



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 230/14 prot.

Datë 12.03.2024

V E N D I M
Nr. 272/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 215/2024, datë 22.02.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent”, me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Ankimues: “Health & Light” SHPK, me NUIS L42231011L, me adresë: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Nd.11, Shk.4, Ap.4, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me adresë: Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 22.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 215/2024, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “Loti 1 - Mirëmbajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent”, me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.*
2. *Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.345/19 prot., datë 07.03.2024, protokolluar me tonën nr. 230/11 prot., datë 11.03.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin Nr.215/2024, datë 22.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent”, me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.345/19 prot., datë 07.03.2024, protokolluar me tonën nr. 230/11 prot., datë 11.03.2024, autoriteti kontraktor njofton, se ka zbatuar vendimin Nr.215/2024, datë 22.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “*Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent*”, me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ky verifikim rezultoi, se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 215/2024, datë 22.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, duke lënë të skualifikuar operatorin ekonomik “Health & Light” SHPK, sipas këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-85014-10-24-2023, me objekt: “*Loti 1 - Mirembajtje Pajisje mjekësore prodhues Philips /ose ekuivalent*”, me fond limit 88 858 534.38 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

